

VENDIM
Nr. 85, datë 26.12.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:
Bashkim Dedja kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

në datën 23.11.2017, me sekretare Blerina Çinari, mori në shqyrtim në seancë plenare, me dyer të hapura, çështjen me nr. 61 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme (AREA), në mungesë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga znj. Lorana Kasapi dhe z. Eduart Saliaj.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, përfaqësuar në gjykim nga z. Eduart Saliaj.

Enti Rregullator i Energjisë, përfaqësuar në gjykim nga znj. Erjola Sadushi, znj. Raimonda Islamaj dhe znj. Julia Guga.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1033, datë 16.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave fikse të energjisë, që do t’u paguhen prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet”.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 11, 17, 18, 131/1, shkronjat “a” dhe “c”, si dhe 134, pikat 1/h dhe 2 të Kushtetutës; nenet 27, 45, 49, 50, 51, 51/a, 72 e vijuese, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Traktati për Krijimin e Komunitetit të Energjisë, datë 25 tetor 2005; Direktiva 2009/28/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 23 prill 2009, “Për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, si dhe ndryshimin dhe shfuqizimin e direktivave 2001/77/KE dhe 2003/30/KE”.

GJYKATA KUSHTETUESE

gjatë kërkimeve paraprake, pasi shqyrtoi kërkesën e kërkuases për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes dhe vlerësimet e subjekteve të interesuara, të cilat kërkuan pranimin e kërkesës për pushimin e gjykimit të çështjes,

VËREN:

Me datën 15.11.2017, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës dhe ka kërkuar heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes para zhvillimit të seancës plenare. Në nenin 31/b të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të shtuar me ligjin nr. 99/2016, parashikohet: “1. Kërkuesi mund të heqë dorë nga kërkesa përpara fillimit të shqyrtimit të saj nga Gjykata Kushtetuese. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese vendos pushimin e gjykimit të çështjes. 2. Gjykata Kushtetuese vendos mospranimin e heqjes dorë nga kërkesa kur vlerëson se shqyrtimi i saj paraqet interes publik.

Në këtë rast Gjykata Kushtetuese arsyeton vendimin për mospranimin e heqjes dorë”.

Bazuar në sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkesa nuk plotëson kushtet e kërkuara të pasjes interes publik, prandaj nuk vazhdon me gjykimin e mëtejshëm të saj, dhe për rrjedhojë pushon gjykimin.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja “c”, dhe 134, pika 1, shkronja “h”, të Kushtetutës, si dhe të neneve 31/b dhe 72 e vijuese, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

Pushimin e gjykimit të çështjes për kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1033, datë 16.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave fikse të energjisë, që do t’i paguhen prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet”.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj